RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

PËR

PËR DISA DHE SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.103/2016 "PËR AKUAKULTURËN" I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim përmirësimin dhe qartësimin e kuadrit ligjor në fushën e akuakulturës, nëpërmjet përcaktimit më të saktë të regjimeve juridike që zbatohen sipas natyrës së mjedisit ku zhvillohet veprimtaria. Ndryshimet e propozuara synojnë të adresojnë paqartësitë e konstatuara gjatë zbatimit të ligjit nr. 103/2016 "Për akuakulturën", të ndryshuar, dhe të krijojnë një kuadër më funksional për zhvillimin e sektorit.

Përmes këtyre ndryshimeve, koncepti i Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) kufizohet për ushtrimin e aktivitetit në zonat ujore detare, ndërsa krijohet një bazë juridike e veçantë për zhvillimin e akuakulturës në ujërat e brendshme, sipërfaqet tokësore dhe sistemet e kontrolluara të prodhimit. Kjo qasje mundëson përshtatjen e procedurave administrative dhe të kërkesave rregullatore me karakteristikat specifike të secilës formë të aktivitetit, duke garantuar një administrim më efikas të sektorit dhe një siguri më të lartë juridike për subjektet që ushtrojnë veprimtari akuakulture.

Objektivi i projektligjit është krijimi i një kuadri rregullator më të qartë dhe më të përshtatshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës, nxitjen e investimeve, shfrytëzimin racional të burimeve natyrore dhe përmirësimin e menaxhimit të veprimtarive të akuakulturës në përputhje me nevojat e zhvillimit të sektorit dhe praktikat më të mira të administrimit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian për Kapitullin 13 "Peshkimi" dhe me objektivat e politikave kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të akuakulturës. Hartimi i këtij projektligji nuk lidhet drejtpërdrejt me nevojën për përafrim të mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e akuakulturës, por synon, ndër të tjera, adresimin e disa çështjeve të evidentuara gjatë procesit të *screening bilateral* me Komisionin Evropian, në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm te akuakulturës në ujërat e brendshme dhe në sipërfaqet tokësore.

Projektligji është gjithashtu në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030, si dhe me Strategjinë Ndërsektoriale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027, e cila parashikon zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrues të sektorit të akuakulturës, diversifikimin e formave të prodhimit dhe nxitjen e investimeve në këtë sektor.

Në mënyrë të veçantë, ndryshimet e propozuara mbështesin objektivat strategjikë për zhvillimin e akuakulturës në ujërat e brendshme dhe në sipërfaqet tokësore, si dhe promovimin e përdorimit të sistemeve të kontrolluara të prodhimit, nëpërmjet krijimit të një kuadri rregullator më të qartë dhe më të përshtatshëm për këto forma të veprimtarisë. Këto masa pritet të kontribuojnë në shfrytëzimin më efikas të burimeve, rritjen e kapaciteteve prodhuese të sektorit dhe garantimin e zhvillimit të tij të qëndrueshëm në përputhje me politikat kombëtare të zhvillimit ekonomik dhe rural.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nevoja për hartimin e këtij projektligji lind nga problematikat e hasura gjatë zbatimit të ligjit nr. 103/2016 "Për akuakulturën", të ndryshuar, veçanërisht në lidhje me zbatimin e një regjimi të njëjtë juridik për forma të ndryshme të veprimtarisë së akuakulturës, të cilat zhvillohen në mjedise me karakteristika të ndryshme fizike, juridike dhe administrative.

Kuadri ligjor aktual bazohet në konceptin e Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA), i cili është konceptuar kryesisht për planifikimin dhe menaxhimin e aktivitetit të akuakulturës në hapësirat ujore detare. Megjithatë, përvoja e zbatimit të ligjit ka treguar se ky koncept është vështirë i zbatueshëm për aktivitetet e akuakulturës që zhvillohen në ujërat e brendshme, në sipërfaqe tokësore ose në sisteme të kontrolluara prodhimi. Në këto raste, procedurat që lidhen me krijimin dhe miratimin e ZPA-ve rezultojnë joproporcionale dhe nuk pasqyrojnë natyrën e aktivitetit, i cili zhvillohet shpesh në sipërfaqe të kufizuara, në prona publike ose private dhe në kushte të kontrolluara prodhimi.

Për këtë arsye, projektligji parashikon kufizimin e zbatimit të konceptit të ZPA-ve vetëm për aktivitetet e akuakulturës detare, për të cilat planifikimi hapësinor dhe koordinimi me përdoruesit e tjerë të hapësirës detare mbetet një kërkesë e domosdoshme. Njëkohësisht, krijohet një bazë juridike e veçantë për zhvillimin e akuakulturës në ujërat e brendshme, në sipërfaqet tokësore dhe në sistemet e integruara ose të kontrolluara të prodhimit, duke mundësuar procedura më të përshtatshme dhe më efikase për autorizimin dhe zhvillimin e këtyre aktiviteteve.

Një tjetër ndryshim me rëndësi që parashikohet në projektligj lidhet me përcaktimin e afatit të kontratës së akuakulturës në 20 vjet. Ky ndryshim synon të garantojë siguri më të madhe juridike dhe ekonomike për investitorët, duke marrë në konsideratë natyrën afatgjatë të investimeve në sektorin e akuakulturës, të cilat karakterizohen nga kosto të larta fillestare dhe periudha të gjata të rikuperimit të investimit. Përcaktimi i kohëzgjatjes së kontratës në 20 vjet pritet të nxisë investime të reja, të mbështesë modernizimin e kapaciteteve prodhuese, të përmirësojë aksesin në financim dhe të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit. Gjithashtu, ky ndryshim krijon kushte më të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm të aktivitetit të operatorit dhe për rritjen e prodhimit e të vlerës së shtuar në ekonomi.

Ndryshimet e propozuara paraqesin një sërë përparësish, pasi qartësojnë regjimet juridike të zbatueshme sipas llojit të aktivitetit, rrisin sigurinë juridike të operatorëve ekonomikë, eliminojnë paqartësitë e evidentuara gjatë zbatimit të ligjit dhe përmirësojnë administrimin e sektorit nga institucionet përgjegjëse. Gjithashtu, ato krijojnë kushte më të favorshme për investime, reduktojnë barrën administrative për aktivitetet që zhvillohen në ujërat e brendshme dhe në sipërfaqet tokësore dhe

mbështesin zhvillimin e formave moderne të prodhimit, përfshirë sistemet e akuaponisë dhe teknologjitë e kontrolluara të kultivimit. Në tërësi, ndryshimet e propozuara synojnë krijimin e një kuadri ligjor më funksional, më të përshtatur me karakteristikat e ndryshme të veprimtarive të akuakulturës dhe më të favorshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit.

Efektet e pritshme të projektligjit:

- krijimi i një kuadri ligjor më të qartë, më funksional dhe më të përshtatshëm me realitetin e sektorit të akuakulturës;
- rritja e investimeve në këtë fushë;
- zgjerimi i aktiviteteve të akuakulturës në ujërat e brendshme dhe në sipërfaqet tokësore;
- përmirësimi i menaxhimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Në tërësi, ndryshimet pritet të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrues të sektorit të akuakulturës, në përputhje me objektivat e politikave kombëtare për zhvillimin e bujqësisë, peshkimit dhe zonave rurale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin e legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji ka **19** nene, me përmbajtje si vijon:

Neni 1, parashikon një ndryshim lidhur me unifikimin e terminologjisë ku kudo në ligj, fjala *"aktivitet"* zëvendësohet me fjalën *"veprimtari"*.

Neni 2, parashikon plotësimin e nenit 3 të ligjit me pesë përkufizime të reja, me qëllim qartësimin dhe kategorizimin e formave të ndryshme të veprimtarisë së akuakulturës. Konkretisht, përcaktohen konceptet e akuakulturës në ujërat e brendshme, akuakulturës tokësore, akuakulturës detare dhe akuaponisë, si dhe sistemet e integruara të prodhimit duke krijuar një bazë më të qartë ligjore për rregullimin dhe zhvillimin e këtyre aktiviteteve sipas karakteristikave të mjedisit ku ushtrohen.

Neni 3 riformulon pikat 1 dhe 2 të nenit 4, duke përcaktuar se Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) zbatohen për zonat ujore detare dhe miratohen në kuadër të një sistemi planifikimi që siguron integrimin e aktivitetit të akuakulturës me përdorimet e tjera të hapësirës detare, me qëllim shmangien e konflikteve në përdorimin e këtyre zonave.

Neni 4 rishikon dispozitat e nenit 5 duke saktësuar se Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) kufizohen në zona ujore detare të dedikuara për zhvillimin e akuakulturës detare, së bashku me infrastrukturën në shërbim të saj. Gjithashtu, përcaktohet procedura e përgatitjes dhe miratimit të ZPA-ve, duke forcuar koordinimin ndërinstitucional dhe duke parashikuar konsultime publike kur zonat e propozuara ndodhen në afërsi të zonave të mbrojtura. Ndryshimet theksojnë gjithashtu integrimin e ZPA-ve në procesin e planifikimit të hapësirës detare dhe rëndësinë e të dhënave të grumbulluara për menaxhimin e qëndrueshëm të akuakulturës dhe të përdorimeve të tjera të hapësirës detare.

Neni 5 riformulon tërësisht nenin 8 të ligjit, duke përcaktuar qartë format dhe vendet ku mund të ushtrohet veprimtaria e akuakulturës, konkretisht në zonat ujore detare të miratuara si ZPA, në ujërat e brendshme dhe në sipërfaqet tokësore. Ndryshimet saktësojnë se ushtrimi i akuakulturës në ujërat e brendshme dhe në sipërfaqet tokësore nuk kushtëzohet nga miratimi i një Zone të Përcaktuar për Akuakulturë (ZPA). Gjithashtu, përcaktohen procedurat për fitimin e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit, duke diferencuar rastet që i nënshtrohen konkurrimit publik nga ato që zhvillohen në sipërfaqe tokësore private. Neni rregullon gjithashtu marrëdhënien kontraktore me ministrinë, detyrimin për pajisjen me licencë përkatëse, kompetencat

e strukturës përgjegjëse për akuakulturën në procesin e licencimit, si dhe ndalimin e ushtrimit të aktivitetit pa kontratë dhe licencë.

Neni 6 shton nenin 8/1, i cili krijon bazën ligjore për zhvillimin e sistemeve të akuaponisë si një formë e integruar e prodhimit që kombinon akuakulturën me kultivimin e bimëve. Dispozita përcakton kushtet e zhvillimit të këtij aktiviteti, kërkesat për pajisjen me të drejtën e ushtrimit të aktivitetit dhe licencimin përkatës, si dhe detyrimin për sigurimin e lejeve dhe autorizimeve të nevojshme sipas legjislacionit sektorial.

Neni 7 riformulon nenin 9 të ligjit, duke rregulluar mënyrën e dhënies në përdorim ose me qira të pronave tokësore publike, shtetërore ose vendore, për zhvillimin e veprimtarive të akuakulturës. Dispozita përcakton marrëdhënien ndërmjet fitimit të të drejtës së përdorimit të pronës dhe lidhjes së kontratës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës, si dhe qartëson trajtimin e të ardhurave nga qiradhënia dhe përcaktimin e vlerës së qirasë sipas legjislacionit përkatës.

Neni 8 riformulon nenin 10 të ligjit, duke rregulluar dhënien në përdorim të sipërfaqeve ujore detare të miratuara si Zona të Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) dhe të sipërfaqeve ujore të brendshme për zhvillimin e veprimtarive të akuakulturës. Dispozita përcakton procedurat për lidhjen e kontratës për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit, kushtet për përdorimin e sipërfaqeve ujore, mënyrën e përcaktimit të vlerës së qirasë dhe trajtimin e të ardhurave që rrjedhin nga dhënia në përdorim e tyre.

Neni 9 shfuqizon nenin 11 të Ligjit.

Neni 10 riformulon nenin 12 të ligjit, duke përcaktuar kushtet për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës në zonat ujore detare të miratuara si ZPA, në ujërat e brendshme dhe në sipërfaqet tokësore. Dispozita qartëson se aktiviteti duhet të zhvillohet vetëm brenda zonës ose sipërfaqes së përcaktuar në kontratën përkatëse dhe në përputhje me llojet dhe sasitë e organizmave ujorë të miratuara. Gjithashtu, parashikohet mundësia e ndryshimit të kontratës për ndryshimin e llojeve ose rritjen e kapacitetit prodhues, pas një vlerësimi teknik dhe në përputhje me kapacitetin mbajtës të zonës, kushtet mjedisore dhe kërkesat e legjislacionit përkatës.

Përjashtohen nga këto procedura llojet e organizmave ujorë që i nënshtrohen një regjimi të posaçëm sipas dispozitave të ligjit.

Neni 11 riformulon nenin 13 të ligjit, duke përcaktuar kohëzgjatjen e kontratës për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës në sipërfaqet ujore dhe tokësore në 20 vjet. Për rastet kur aktiviteti zhvillohet në sipërfaqe tokësore shtetërore ose vendore, kohëzgjatja e kontratës së akuakulturës lidhet me afatin e kontratës për përdorimin e sipërfaqes përkatëse, pa tejkaluar periudhën 20-vjeçare. Gjithashtu, dispozita përcakton detyrimin për përfshirjen në kontratë të afateve për fillimin dhe përfundimin e investimeve dhe veprave të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, të cilat duhet të përfundojnë brenda tre vjetëve nga nënshkrimi i kontratës.

Neni 12 riformulon nenin 16 të ligjit, duke përcaktuar procedurën për përfitimin e së drejtës së ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës në zonat ujore detare të miratuara si ZPA dhe në ujërat e brendshme ~~dhe në sipërfaqet tokësore shtetërore ose vendore.~~ Dispozita parashikon që dhënia e kësaj të drejte të realizohet nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik të organizuara nga ministria përgjegjëse, ku mund të aplikojnë persona fizikë ose juridikë në përputhje me kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në ligj.

Neni 13 ndryshon nenin 20 të ligjit, duke saktësuar rastet e përfundimit të kontratës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës në rast të humbjes së personalitetit juridik të personit juridik ose të çregjistrimit nga regjistri tregtar të personit fizik. Gjithashtu, përcaktohet detyrimi i subjektit ose i përfaqësuesit të tij ligjor për të njoftuar menjëherë ministrinë në rastet kur ndodhin këto ndryshime, me qëllim garantimin e administrimit të rregullt të marrëdhënieve kontraktore dhe të aktivitetit të akuakulturës.

Neni 14 shfuqizon nenin 22 të Ligjit.

Neni 15 ndryshon pikën 2 të nenit 23, duke përcaktuar detyrimin që, në rastet e ndërprerjes ose zgjidhjes së kontratës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës në sipërfaqe ujore ose tokësore publike apo private, autoriteti përgjegjës të njoftojë edhe institucionin përgjegjës për administrimin e pronës ose sipërfaqes përkatëse.

Neni 16 riformulon nenin 24 të ligjit, duke rregulluar procedurat që ndiqen pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së kontratës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës. Dispozita përcakton se, për aktivitetet e zhvilluara në sipërfaqe ujore ose tokësore publike, zona ose sipërfaqja përkatëse shpallet për konkurrim publik, pas marrjes së mendimit të institucioneve përgjegjëse, përveç rasteve të rinovimit të kontratës sipas ligjit. Gjithashtu, për aktivitetet e zhvilluara në sipërfaqe tokësore private, parashikohet e drejta e subjektit për të aplikuar për lidhjen e një kontrate të re, në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 17 parashikon ndryshime dhe shtesa në nenin 25 të ligjit, duke rishikuar kushtet për rinovimin e kontratës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës.

Neni 18 parashikon aktet nënligjore që do të miratohen në zbatim të këtij ligji.

Neni 19 parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Për hartimin e projektligjit është ngritur një grup pune me Urdhër Ministri nr. 123, datë 9.3.2026 *"Për ngritjen e grupit të punës për ndryshimet në ligjin nr. 103/2016 "Për Akuakulturën"*, i ndryshuar.

Në kuadër të detyrimit të konsultimit publik, projektligji do të publikohet në RENJKP dhe u dërgua për mendim në ministritë e linjës dhe Këshillin Konsultativ për Vetëqeverisjen Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk sjell efekte financiare ne buxhetin e shtetit.

MINISTËR

Andis Salla